



KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE E TË LIRIVE TË NJERIUT
COUNCIL FOR THE DEFENCE OF HUMAN RIGHTS AND FREEDOMS

Rr. Nëna Terezë nr. 24/2 – I/I, Prishtinë-Kosovë; tel. 381 (0) 249006 fax: 381 (0) 38 244029

E-mail: kmdl原因@gmail.com; <http://www.cdhrf.org>

KMDLNj viziton Inspektoratin Policor të Kosovës

Më 29 shtator 2017, KMDLNj vizitoi Inspektoratin e Policisë së Kosovës dhe u takua me z. Hilmi Mehmeti, kryeshef i IPK , me bashkëpunëtorë në kuadër të vazhdimit të bashkëpunimit midis dy institucioneve që kanë mandat të monitorojnë punën e Policisë së Kosovës.

Edhe më heret KMDLNj ka kërkuar që të përmirësohen kushtet e punës për Inspektoratin Policor të Kosovës, si ato fizike ashtu edhe ato materiale duke shpresuar se qeveria e re do ta trajtojë këtë çështje me prioritet dhe seriozitet.

Edhe më tutje po vazhdon të jetë problem kryesor lokacioni ku gjendet Inspektorati Policor i Kosovës. IPK është në një lokacion (Hajvali) që është vështirë i qasshëm për qytetarët që duan t'i paraqesin ankesat e tyre, për dëshmitarë të rasteve dhe, gjithashtu i kufizon aktivitetet monitoruese të inspektorëve të këtij inspektorati shkak se për çdo aktivitet duhet të përdoret vetura.

Si vërejtje e IPK ishte publikimi i kallëzimeve penale/vendimeve nëpër media edhe në raste kur kjo është në kundërshtim me ligjin dhe kur e pengojnë ecurinë e hetimeve.

KMDLNj , edhe në të ardhmën do të bashkëpunojë me IPK dhe kërkon nga qytetarët t'i paraqesin rastet në rast se ndaj tyre bëhet padrejtësi kur policia i tejkalon autorizimet zyrtare apo kur sjelljet janë në kundërshtim me ligjet në fuqi. Puna e IPK ndihmon në sjelljet e policëve duke marrë masa ligjore ndaj atyre që i shkelin këto ligje.

KMDLNj ka bashkëpunim të mirë me IPK dhe nuk ka mbetur asnjë rast i paraqitur nga KMDLNj e që nuk është trajtuar apo nuk ka marrë përgjigje nga Inspektorati Policor i Kosovës.

29 shtator 2017

Shërbimi për Informim